



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 4 maj 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Bajram Kosumi, Radmila Vujoviq, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Selvije Halimi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sokol Haziri - Komisionier i Nihmës Juridike, Virgjina Dumnica - Zëvendëskomisionere, Drita Rexhepi - Koordinatore e Ndihmës Juridike, Shqipe Hajredini – ZKM, Petrit Hysaj – OSBE, Lejla Selimi – , Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 19 dhe 26 prillit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit për Ndihme Juridike për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në projektligjet për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, në Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, në projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës, në Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, në Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.
5. Përgatitjet për dëgjimet publike të 5 dhe 14 maj 2010,
6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për gjykatat,

7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 19 dhe 26 prillit 2010,

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 19 dhe 26 prill 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit për Ndihme Juridike për vitin 2009

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe ata që e monitorojnë punën e Komisionit. Në vazhdim theksoi se e kemi marrë me kohë Raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike dhe i njoftoi të pranishmit se shqyrtimi i këtij raporti bie në kompetencë të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ne jemi ata që do t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtimin dhe për miratimin e tij. Ftoi Sokol Hazirin ta merrte fjalën.

Sokol Haziri, Komisionier i Nihmës Juridike - Në vija të trasha e paraqiti një kronologji të aktiviteteve të Komisionit për Ndihmë Juridike, me fokus funksionimin e këtij komisioni. I njoftoi anëtarët e Komisionit për zëvendësimet që i ka bërë Komisioni për ndihmë juridike, sepse dy nga anëtarët kanë kaluar në Gjykatën Kushtetuese. E përshëndeti iniciativën për iniciimin e ligjit për ndihmë juridike, sepse rregullorja në fuqi ka pasur shumë mangësi. Përmendi donacionin që kanë fituar nga UNDP – ja, me të cilën kemi rritur kapacitetet në pesë byro të qarkut, si Zyra në Graçanicë, në Ferizaj, në Gjakovë, në Dragash dhe në Mitrovicë. Në vazhdim foli për numrin e zyrtarëve të punësuar në këto zyra, si dhe foli për bashkëpunimin që e kanë me Oden e Avokateve të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Drita Rexhepi - Duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se edhe në Prishtinë, për shkak të nevojës së madhe kemi hapur edhe tri zyra të tjera. Theksoi se kemi hyrë në partneritet me dy organizata joqeveritare me ndihmën e të cilave kemi hapur një Zyrë në Podujevë dhe një në Gjakovë. Si shqetësim të Komisionit për Ndihmë Juridike përmendi numrin e vogël të stafit, duke pasur parasysh vëllimin e madh të lëndëve.

Gani Geci - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve foli për mandatin dhe funksionin e Komisionit për Ndihmë Juridike kur është paraparë përfaqësimi i palëve në gjykata. Theksoi se kemi raste në Kosovë kur avokatët nuk dëshirojnë të përfaqësojnë klientët edhe atëherë kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare. Pyeti se a keni paraparë ndonjë formë të ndihmës për këto raste që t'ju ofrohet ndihmë këtyre njerëzve?

Bajram Kosumi - Në fjalën e tij ngriti çështjen se në Raport janë dhënë vetëm numri i rasteve që janë shqyrtuar, por nuk janë dhënë shifra se sa raste nuk keni arritur t'i shqyrtoni, sepse ky do të ishte një argument që të hapen zyra të reja, nëse nuk keni pasur mundësi t'i përfundoni këto raste.

Armend Zemaj - Duke ju referuar Raportit tha se këtu shihet që shumica e rasteve janë këshilla juridike dhe padi. Theksoi mungesën e informimit të qytetarët për këtë formë ndihme, sepse edhe në takimin e kaluar e kemi shtruar këtë çështje, ngase edhe komunitetet e tjera duhet të jenë të informuar, jo vetëm në gjuhët zyrtare, por edhe në gjuhën e vet në shfrytëzimin e kësaj të drejte. Pyeti sa është bërë në edukimin juridik publik, cilat ishin rezultatet nga viti i kaluar deri më sot dhe cilat janë planet në këtë rrafsh?

Ibrahim Makolli - Ndhmën juridike e cilësoi si të domosdoshme në vend, sepse një numër i qytetareve nuk e kanë mundësinë për të paguar. Në rekomandime kemi pritur ma shumë se si ju e shihni organizimin e mëtutjeshëm. Është e nevojshme hapja e zyrave në secilën komunë të Kosovës. Ajo që është dashur të përfshihet në këtë raport, është se sa njerëz kanë realizuar ndihmë dhe sa nuk kanë përfituar ndihmë për arsye të ndryshme. Pyeti se a është ndonjë nga zëvendëskomisionarët që u ka skaduar mandati?

Kryetari - Kërkoj sqarim duke theksuar se janë nevojat ma të mëdha të qytetarëve për çështjet penale, prandaj si është menduar për të dalë nga kjo situatë? A do t'i kushtojë kjo buxhetit, sepse ju do të angazhoni avokat? Pyeti a ka ndonjë anëtar, të cilit i ka skaduar mandati?

Gani Geci - Në fjalën e tij të sërishme ofroi sqarime se si funksionon ndihma juridike në shtetin Gjerman, veçmas për ato raste kur pala nuk ka mundësi për të paguar për ndihmë juridike.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigjën: Sokol Haziri, Virgjina Dumnica dhe Drita Rexhepi.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi i Kosovës Raporti vjetor i Komisionit për Ndhmë Juridike për vitin 2009, në një nga seancat e radhës.

- 4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në projektligjet për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, në projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, në Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës, në Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, në Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë**

Kryetari – I paraqiti propozimamendamentet e këtyre projektligjeve që të konstatohet baza juridike: Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, si dhe Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Ishte i diskutueshëm amendamenti i tretë në Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, ku diskutuan: *Armend Zemaj, Gani Geci, Ramadan Gashi dhe Ibrahim Makolli*. Pas diskutimeve që u zhvilluan ishte konstatim i përgjithshëm se projektligjet dhe amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni shqyrtoi propozimamendamentet në këto projektligje: Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, Projektligji për Kryqin e Kuq të Kosovës, Projektligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, si dhe Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Komisioni vlerëson se projektligjet dhe amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5. Përgatitjet për dëgjimet publike të 5 dhe 14 maj 2010

Kryetari i njoftoi anëtarët se më 5. 5. 2010 në orën 11: 00 do të mbahet dëgjimi publik, lidhur me përmbushjen e detyrave nga Plani i Veprimit për Integritet Evropian.

6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për gjykatat

Kryetari propozoi të formohet grupi punues për shqyrtimin e P/L për gjykatat me këtë përbërje: Bahri Hyseni, Mufera Şinik , Bajram Kosumi, Kolë Berisha dhe Ramadan Gashi.

Meqë nuk pati vërejtje rreth propozimit për formimin e grupit punues, Komisioni nxori këtë:

P e r f u n d i m

Formohet grupi punues me këtë përbërje: Bahri Hyseni, Mufera Şinik , Bajram Kosumi, Kolë Berisha dhe Ramadan Gashi.

7. Të ndryshme

Nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 03

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni
